



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

Numri i lëndës: 2019:193168

Datë: 19.03.2024

Numri i dokumentit: 05471235

C.nr. 1068/16

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINE- Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtar Përparim Zeka, në çështjen juridike kontestimore të paditëses K. K. për D. dhe F. me E. E. Sh.a kundër të paditurës Xh. S. nga Prishtina me objekt të kontestit kompensimin e dëmit material, jashtë seancës gjyqësore me datë 18.03.2024 nxjerr këtë

A K T G J Y K I M

PËR SHKAK TË PA DËGJUESHMËRISË – MOSBINDJES

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses K. K. për D. dhe F. me E. E. Sh.a dhe DETYROHET i padituri Xh. A. S.me adrese në rr. ... p/n në Prishtinë, që paditëses, K. K. për D. dhe F. me E. E. Sh.a, t’ia kompensoje shumën në lartësi prej, 149.64 euro, dhe atë me kamatë ligjore duke filluar prej ditës së ushtrimit të padisë e gjërë në pagesën definitive si dhe shpenzimet e këtij kontesti – të gjitha në afat prej 15 nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin të përmbarrimit të detyrueshëm.

II. DETYROHET e paditura Xh. A. S. nga Prishtinë, t’ia paguaj paditësit shpenzimet procedurale në shumë prej 30 euro në emër të taksës gjyqësore, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja, me padi e datës 29.04.2016, ka kërkuar që të detyrohet e paditura Xh. A. S. nga Prishtina, që paditëses, t'ia kompensoje shumen në lartësi prej 149.64 euro, (njëqindekatërdhjetëenëntë dhe gjashtëdhjetëekatër euro). në emër të rimbursimit të dëmit material të shkaktuar me datës 19.10.2011, me kamat ligjore duke filluar prej ditës së ushtrimit të padisë 29.04.2016 e gjerë në pagesën definitive si dhe shpenzimet e këtij kontesti, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore pas shqyrtimit paraprak të padisë ka nxjerrë aktvendimin për përgjigje në padi me datë 13.04.2023, të cilin i padituri e ka pranuar me datë 20.04.2023 (e cila është konfirmuar përmes fletë kthesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës).

Me aktvendimin për përgjigje në padi, gjykata e ka njoftuar të paditurin për detyrimin ligjor për dhënie të përgjegjës në padi dhe për pasojat ligjore që do t'i ketë nëse nuk paraqet përgjigje në padi, gjegjësisht për mundësinë që gjykata të marrë aktgjykim për shkak të mosbindjes - pa dëgjueshmërisë.

I padituri, pavarësisht se e ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me padinë dhe provat materiale në këtë çështje juridike kontestuese, nuk ka paraqitur përgjigje në padi brenda afatit ligjor.

Gjykata, pasi i ka vlerësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mosbindjes, ka gjetur së në rastin konkret plotësohen të gjitha kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit në fjalë nga neni 150 paragrafi 1 pikat a), b) dhe (c) të LPK-së, nëse të paditurit i është dorëzuar padia dhe thirrja për përgjigje në padi, se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi dhe se faktet në të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vetë paditësi apo me faktet e ditura botërisht.

Themelësia e kërkesëpadisë del nga provat të cilat gjenden ne shkresat e lëndës, nga dosja, fatura mbi llogarinë e dëmit Nr.37328 e datës 22.11.2011 dhe aktgjykimi P.Nr. 864/12 e datës 09.10.2014.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Për kamatën gjykata vendosi duke u mbështetur në nenin 277 të LMD-së.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452të LPK-së, për taksë gjyqësore në shumën prej 20 euro.

Gjykata, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke i'u referuar dispozitës së nenit 150 par.1 pika a, b, dhe c te LPK-së, e në lidhje më dispozitat e nenit 35 par. 7, dhe dispozitave të nenit 245 par.1 dhe 2, të LMD-së.

#### GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË,

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.1068/16 dt. 17.11.2023.

Gjyqtari

Përparim Zeka

#### UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 15 ditë, nga dita e pranimit të të njëjtit, drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë.